

NDRYSHIME TË SKK 5 “AKTIVET AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE” - I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 1, 2, 18, 52 dhe 116 janë ndryshuar. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTIVI DHE BAZA E PËRGATITJES

1. Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 5 *Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale* (SKK 5 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranura në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 25, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” publikuar në maj 2018.

2. SKK 5 mbështetet në një numër standardesh ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë SNK 16 *Aktivet afatgjata materiale*, SNK 38 *Aktive jomateriale*, SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve*, SNK 23 *Kostot e huamarrjes* dhe SNRF 5 *Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe operacionet e vijueshme*. **SKK 5 i përmirësuar është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 16 *Aktivet afatgjata materiale të investuara*, Seksionin 17 *Toka, Ndërtesa, Makineri dhe Pajisje*, Seksionin 18 *Aktivet afatgjata jomateriale përveç emrit të mirë*, Seksionin 25 *Kostot e huamarrjes*, Seksionin 27 *Zhvlerësimi i aktiveve*, të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për NVM- të (2009)**. Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM (2009), është dhënë në paragrafin 117. Për rastet, të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 5 e përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe të ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 11 të Ligjit nr. 25, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në maj 2018.

Vlerësimi i mëpasshëm

18. Njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël modelin e kostos (i cili shpjegohet në paragrafin 19), ose modelin e rivlerësimit (i cili shpjegohet në paragrafët 20-28) dhe do të zbatojë atë model për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet. Modeli i rivlerësimit nuk kërkohet të zbatohet nga njësia ekonomike të vogla.

TRAJTIMI KONTABËL PËR AKTIVET AFATGJATA TË INVESTUARA

Vlerësimi i mëpasshëm

52. Aktivi afatgjatë i investuar, vlera e drejtë e të cilit të mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje. Nëse një interes mbi një pasuri të mbajtur sipas një kontrate qiraje është klasifikuar si aktiv afatgjatë i investuar, zëri i kontabilizuar me vlerën e drejtë është ky interes dhe jo pasuria bazë. Një njësi ekonomike duhet të trajtojë të gjitha aktivet e tjera

të investuara si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim. Përrjashtim bëjnë njësitë ekonomike të vogla të cilat inkurajohen por nuk kanë detyrimin të zbatojnë modelin e vlerës së drejtë në vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale të investuara.

DATA E HYRJES NË ZBATIM

116. Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ndryshimet e këtij Standardi do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2020. Ndryshimet me datë efektive 1 janar 2020 do të zbatohen në mënyrë prospektive.